



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË  
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKA  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



**RREGULLORE PËR TATIMIN  
MBI PRONËN E PALUAJTSHME**

SUHAREKË  
2014

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, Nr-03/L-204, të datës 07.11.2010, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-88/2010), nenin 9, të Ligjit për Financat e pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, të datës 13.03.2008, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008), nenin 12, 17 dhe 24, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 29, 54 dhe 56, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 29.09.2014, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONË E PALUAJTSHME**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1.**

Duke u bazuar në nenin 6, të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, Nr-04/L-204, të datës 01.11.2010, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-88/2010) dhe udhëzimit administrativ, Nr-04/2011, për përcaktimin e vlerës së pronës së paluajtshme dhe standardet e vlerësimit, nga Komuna do të caktohet baza tatimore si më poshtë:

Sipas Zonave në bazë të vlerës së tregut në m<sup>2</sup>

<b>Destinimi i objektit</b>	<b>Zona I</b>	<b>Zona II</b>	<b>Zona III</b>	<b>Zona IV</b>	<b>Zona V</b>
Prona rezidenciale-shtëpi	400.00 €	350.00 €	300.00 €	250.00 €	150.00 €
Prona rezidenciale-banesë	450.00 €	-	-	-	-
Prona industriale	400.00 €	350.00 €	150.00 €	130.00 €	120.00 €
Prona komerciale	750.00 €	550.00 €	450.00 €	350.00 €	200.00 €
Pishina/qendra sportive	120.00 €	110.00 €	100.00 €	90.00 €	90.00 €
Depo dhe Magazin	300.00 €	250.00 €	200.00 €	150.00 €	100.00 €

#### **Neni 2.**

Duke u bazuar ne vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm ne vlerën e saj në Komunën e Suharekës janë përcaktuar **5, zona** te cilat paraqesin ndryshime të theksuara ne vlerën e pasurisë.

#### **Neni 3.**

##### **Zona e parë**

**3.1** Përfshin të gjitha banesat, shtëpitë dhe lokalet afariste që gjenden përkaj rrugës “Brigada 123”, rruga magjistrale Suharekë-Prizren deri në Gradina, “Hajdin Berisha”, “Mulla Nura”, “Qendra zejtare numër Nr-1 dhe Qendra zejtare numër Nr-2”,

#### Zona e dytë

3.2 Përfshinë të gjitha shtëpitë dhe objektet afariste të cilat janë jashtë zonës së parë në brendi të qytetit dhe rrugën "Brigada 123", nga Shiroka deri te ura e Sopisë.

#### Zona e tretë

3.3 Përfshinë disa fshatra të Komunës së Suharekës siç janë: Sopi, Savrovë, Bukosh, Vraniq, Reqan, Mushtishtë, Dubravë, Sallagrazhdë, Grejkoc, Gjinoc, Gelancë, Leshan, Tërrnje, Neprëbisht, Samadrexhë, Studenqan, Reshtan, Semetisht dhe Peqan.

#### Zona e katërt

3.4 Përfshinë fshatrat në zonat kodrinë malore të Komunës së Suharekës, apo vendbanimet rurale që janë më në thelësi si fshatra janë: Bllacë, Duhël, Stravuqin, Krushic e Ulët, Budakovë, Krushic e Eperme, Mohlan, Doberdelan, Nishor, Kosterc, Sllapuzhan, Dvoran, Popolan.

#### Zona e pestë

3.5 Përfshin fshatrat në zonat më të thella malore: Dëlloc, Maqitevë, Papaz, Vërshec, Qadraq, Grejqec, Luzhnicë, Javor.

#### Neni 4.

Në pajtim me neni 7, të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, Nr-04/L-204, të datës 01.11.2010, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-88/2010), normat tatimore të tatimit në prone për pronën e paluajtshme për vitin tatimor, 2013, për Komunën e Suharekës do të jenë siç vijon:

Nr	Lloji i pronës	Norma e tatimit
1.	Prona rezidenciale-shtëpi	0.15%
2.	Prona rezidenciale-banesë	0.15%
3.	Prona industriale	0.18%
4.	Prona komerciale	0.20%
5.	Pishina/qendra sportive	0.18%
6.	Depo,magazin	0.18%

#### Neni 5.

Pronat të cilat lirohen nga tatimi në prone e të cilat janë të cekura në nenin 8, të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, Nr-04/L-204, të datës 01.11.2010, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-88/2010), lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Suharekës.

#### Neni 6.

Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 16, të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, Nr-04/L-204, të datës 01.11.2010, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-88/2010) dhe udhëzimit administrativ, Nr-06/2011, për shtyrjen e pagesës për tatimin në pronë.

#### Neni 7.

Në pajtim me nenin 22, të Ligjit Nr-04/L-204, për tatimin në pronën e paluajtshme, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-88/2010") dhe udhëzimit administrativ 05/2011, për ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme, Kryetari i Komunës, emëron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2014.

#### Neni 8.

Ligji Nr-04/L-204, për tatimin në pronën e paluajtshme, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-88/2010") dhe udhëzimet administrative me numër, 03/2011, 04/2011, 05/2011, 06/2011, 07/2011, 08/2011, 09/2011 dhe 10/2011, i rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

## II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 9.

Kjo rregullore miratohet nga Kuvendi i Komunës në Suharekë dhe mundë të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

#### Neni 10.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008") nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013 për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

#### Neni 11.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës në Suharekë, shfuqizohet Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës në Suharekë me numër, 01-Nr-16-5428, të datës, 31.08.2012.

#### Neni 12.

Kjo rregullore do të zbatohet-implementohet nga **01 janari i vitit 2015**

### KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-16-6792  
Me date 30.09.2014



Kryesuesi i Kuvendit

Refki GEGA